



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data 7.2.2023
Nr. Prot 685

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së KOMISIONIT RREGULLATOR

E nderuar Kryetare e Komisionit Rregullator,

Të nderuar anëtarë,

Në mbështetje të shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 19, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Komisioneri vë në lëvizje Komisionin Rregullator sa herë që paraqiten çështje të kompetencës së tij.

Ju vë në dijeni, se janë përgatitur projektvendimet si vijon:

1. "Për një shtesë në vendimin nr. 2, datë 31.10.2020, të Komisionit Rregullator, "Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e identifikimit elektronik të zgjedhësve që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë",
2. "Për disa shtesa në vendimin nr. 4, datë 13.11.2020, të Komisionit Rregullator, "Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë".

Propozoj thirrjen e mbledhjes së Komisionit Rregullator për shqyrtimin e këtyre projektvendimeve.

Bashkëlidhur do të gjeni kopje të projektvendimeve dhe relacionit shoqërues.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

